



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 19 Shkurt 2021

Nr: 5

VENDIM

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 11, DATË 28.12.2020 "PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ADMINISTRIMIN DHE SHPËRNDARJEN E VULËS REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË TË VOTIMIT"

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 19.02.2021, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 "Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të KQV-së".

BAZA LIGJORE: Neni 20, paragrafi 1, shkronja "a", të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 144, paragrafi 1, të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Rregullator pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe dëgjoi diskutimet e të pranishëmve, në zbatim të kompetencës së parashikuar në nenin 20, paragrafi 1, shkronja "a", të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008



Data: 19 Shkurt 2021
Nr. 5

Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 "për caktimin e rregullave për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë të komisionit të qendrës së të votimit"

“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 114, paragrafi 1, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

V Ë R E N

Komisioni Rregullator në ushtrim të kompetencës së përcaktuar në nenin 20, paragrafi 1, shkronja “a”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ka miratuar vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të KQV-së”.

Referuar të dhënave të zgjedhjeve pararendëse, vulat rezervë të KQV-ve janë përdorur në një numër shumë të kufizuar të rasteve të nxjerrjes jashtë përdorimit të vulës së KQV-së apo të vulës së Kryetarit të KQV-së. Në vlerësim të këtyre fakteve, prodhimi i vulave rezervë të KQV-ve, jo në numër të barabartë me numrin e QV-ve, nuk çënon garancitë për shmangien e situatave të pavlefshmërisë së zgjedhjeve apo të pavlefshmërisë së votës dhe ndikon në administrimin me ekonomicitet dhe efikasitet të buxhetit të zgjedhjeve.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Komisioni Rregullator, bazuar në nenin 20, paragrafët 1, shkronjat “a”, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 114, paragrafi 1, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të KQV-së”, bëhen këto ndryshime:

1.1 Paragrafi 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, prodhon vula rezervë me tekst unik për zëvendësimin e vulës së KQV-së apo vulës së Kryetarit të KQV-së të nxjerrë nga përdorimi. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përcakton:

- a) numrin e vulave rezervë që do të prodhohen në rang vendi;
- b) formatin, tekstin dhe numrin serial të çdo vule rezervë.



Data: 19 Shkurt 2021
Nr. 5

Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 “për caktimin e rregullave për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë të komisionit të qendrës së të votimit”

1.2 Paragrafi 8 ndryshohet si më poshtë vijon:

Në rast se njoftimi sipas paragrafit 4, të këtij vendimi, bëhet për vulën e Komisionit të Qendrës së Votimit dhe për vulën e Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit të së njëjtës qendër votimi, atëherë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:

- a) pas administrimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të njoftimit/kërkesës të Sekretarit të Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor, merr vendim për nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe të vulës së Kryetarit të Qendrës së Votimit përkatëse dhe zëvendësimin e tyre me vula rezervë;
- b) Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve sipas shkronjës “a” të këtij paragrafi, përcakton numrin e qendrës së votimit, tekstin e secilës vulë që nxirret nga përdorimi, dhe tekstin e secilës vulë rezervë që zëvendëson vulat e nxjerra nga përdorimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Ilijana NANO -

Kryetare

Arens ÇELA -

Anëtar

Dritan ÇAKA -

Anëtar

Helga VUKAJ -

Anëtare

Muharrem ÇAKAJ -

Anëtar

